

Dr. Elisa Berdica - Psikologe/kerkuese shkencore

Profesioni: Psikologe/kerkuese shkencore

Biografia:

Dr. Elisa Berdica ka përfunduar studimet për Bachelor në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Shqipëri, duke vazhduar me nivelin Master Shkencor në drejtimin Psikologji Klinike, në Universitetin e Bolognas, Itali. Ne vazhdim ka përfunduar studimet e doktoratës në Universitetin e Mannheim në Gjermani, ku punon momentalisht si pedagoge në Departamentin e Psikologjisë Klinike dhe Biologjike. Është e angazhuar kryesisht me këshillim, mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Gjatë rrugetimit të saj të gjatë në fushën e psikologjisë, ajo është fokusuar kryesisht në çrregullimet e ankthit (fobitë specifike, fobi sociale, ankth i përgjithësuar, ataket e panikut), depresion, trauma, e çrregullime të zhvillimit, me drejtim konjitiv-bihejvioral. Në fokus të kërkimit të saj shkencor janë emocionet dhe menyra se si ato ndikojnë sjelljen dhe shëndetin tonë mendor, po ashtu dhe promovimi i mirëqenies psikologjike.

Elisa është bashkuar me ekipin e nukjevet.net që nga viti 2011, ku ju ofron këshillim online dhe suport për problemet tuaja. Në vitin 2015 ka mbaruar trajnimin për këshillim online pranë Online Therapy Institute duke u certifikuar si cyber facilitator.